



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 2108/7 prot.

Tiranë më 27.12.2024

REKOMANDIM

Nr. 43, datë 27.12.2024

PËR KONTROLLUESIN “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit ““Communication Progress” Shpk (në vijim, “Kontrolluesi),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 149, datë 27.09.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatim i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI).

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një shoqëri e regjistruar me numër identifikimi K01625001C, në Tiranë, i cili ka si objekt të aktivitetit të tij, ndër të tjera, dizejm, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve, shërbime auditimi të sistemeve, hostim infrastrukture dhe software, hostim i bazës së të dhënave, etj.

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë “*klientë*”, “*punëmarrës*”, “*furnizues*”, “*vizitorë*”, “*punonjës të larguar*”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi administron dokumentacionin e grumbulluar për punonjësit aktual dhe punonjësit e larguar, në dosje fizike.

Lidhur me punonjësit e larguar, Kontrolluesi deklaron se disponon dokumentet si:

- Raporti mjekësor për aftësi në punë;
- Libreza e punës;
- Libreza e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- Diploma/Certifikata kualifikimi nëse ka;
- Certifikatë e Gjendjes Gjyqësore/ Dëshmi Penaliteti;
- Llogari bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank;
- Analiza gjaku (nevojitet një herë në 2 vjet);
- Vizitë tek Okulisti (nevojitet një herë në 2 vjet);
- CV sipas formatit CP;
- Formular i të dhënave personale;
- Letër pranim dorëheqje;
- Formë dorëzimi të pajisjeve në përdorim;
- Formë dorëzimi të librezës së punës/kontributeve.

Nga analizimi i dokumenteve të cilat parashikojnë procedurat dhe masat për proceset përpunuese, si dhe në Rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, rezulton se Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale, për dokumentacionin që administron në funksion të veprimtarisë që ushtron.

Të dhënat e mbledhura nga Kontrolluesi për punonjësit e larguar ruhen, pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me germen “*d*” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, si dhe me Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 11*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar, në përputhje me parashikimin e gremës “*d*”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

3. Kontrolluesi disponon një sistem të video-survejjimit (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të jashtme dhe të brendshme. Nga verifikimi i kryer në vend konstatohet se, Kontrolluesi nuk disponon tabelë informimi për mbikëqyrjen e ambienteve me

sistemin CCTV, në kundërshtim me parashikimin e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejjimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejjimit, të miratuar nga Komisioneri.

4. Kontrolluesi ka lidhur Kontratë Shërbimi Mirëmbajtje me palë të treta, të tilla si Kontrata me “NOA SHA”, me objekt “*Ofruesi i Shërbimit merr përsipër t’i ofrojë Marrësit të Shërbimit për mirëmbajtjen e sistemit informatik IMPRO ERP Burime Njerëzore, sipas specifikave teknike të përshkruara në Aneksin 1: Termat e Suportit të Shërbimit, pjesë integrale e kësaj kontrate*”.

Nga analizimi i kontratës rezulton se, në pikën 3.4 “*Korrigjim i të dhënave*” të Aneksit 1, është parashikuar se klienti (NOA SHA), mund të kërkoj suport nga ofruesi i shërbimit (Kontrolluesi), lidhur me fshirjen e të dhënave, korrigjim i të dhënave, si dhe monitorimi i veprimeve të përdoruesve mbi një grup të dhënash me kërkesë të klientit.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konstaton se, në përmbajtje të Kontratës nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 19*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratoj një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të jetë në përputhje me nenin 20 të Ligjit dhe me Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezulton se, Kontrolluesi ka “*Njoftuar*” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës.

Megjithatë, pas marrjes në dijeni të Urdhrit të hetimit administrativ, Kontrolluesi ka depozituar formularin “*Deklaratë Ndryshimi*”, administruar me tonën me nr. 2148 prot., datë 02.10.2024.

Nga shqyrtimi i “*Deklaratës së Ndryshimit*”, rezulton se ka mangësi në rubrikat si më poshtë:

- Deklarimin në rubrikën 2, të formularit të njoftimit “*Fusha e veprimtarisë*”, të tilla si por pa u kufizuar: “*Telekomunikacion*”, etj.;
- Deklarimin në rubrikën 3, të formularit të njoftimit “*Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”, të tilla si por pa u kufizuar: “*Vizitorë*”, etj.;
- Deklarimin në rubrikën 6, të formularit të njoftimit “*Qëllimi i përpunimit*”, të tilla si por pa u kufizuar: “*Mbikëqyrja ambienteve me CCTV*”, etj.;
- Deklarimin në rubrikën 7, të formularit të njoftimit “*Marrësit e të dhënave personale*”, të tilla si por pa u kufizuar: “*Banka*”, etj.;
- Deklarimin në rubrikën 7, të formularit të njoftimit “*Qëllimi i përhapjes*”, të tilla si por pa u kufizuar: “*Detyrim ligjor*”, etj.;

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “*Njoftim*” mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimet e vazhdueshme të gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre që i jep Ligji.

6. Kontrolluesi ka hartuar Rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” por nga verifikimi rezulton se kjo Rregullore nuk është e plotë, pasi në të nuk parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një Rregullore specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura teknike-organizative mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

7. Kontrolluesi disponon një grup politikash të pa miratuara të periudhave të ndryshme kohore lidhur me sigurinë e informacionit, e konkretisht:
 - Plani për vazhdimësinë e biznesit, datë 02.02.2023;
 - Politika të Menaxhimit të Aksesit dhe Sigurisë për Administratorët e rrjetit;
 - Vendim për caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale;

- Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, 2024;
- Procedurë e ruajtjes dhe arkivimit të të dhënave personale në sistemin elektronik IMPRO, datë 03.02.2023;
- Dokument për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së informacionit (SMSI) në sistemin IMPRO, datë 03.02.2023;
- Skemë e lidhjes së sistemit të hyrje/daljes së kontrolluar;
- Skema e lidhjes së rrjetit kompjuterik në CP;
- Politika e Sigurisë së Informacionit për Communication Progress, datë 03.02.2024;

Konstatohet se, mungojnë elementë të tjerë të sigurisë së të dhënave si “Analiza e Ndikimit në të Dhënat Personale”, “Analiza e sigurisë së sistemit të arkivimit” për të gjitha llojet e proceseve përpunuese gjatë ushtrimit të aktivitetit, “Raport vlerësimi mbi sigurinë në sistemin e arkivimit” elektronik dhe fizik, “Kontrolli i sigurisë së sistemit të përpunimit të të dhënave”, “Hapat që duhet të ndërmerren në rast incidentesh të shkeljes së sigurisë së të dhënave personale”, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Masat e ndërmarra nga Kontrolluesi janë jo të plota, në raport më veprimtarinë e gjerë që kryen. Grupi i politikave që disponon Kontrolluesi nuk aplikohen dhe dokumentohen nga Kontrolluesi, gjatë ushtrimit të aktivitetit sipas proceseve përpunuese.

Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion, një certifikatë të standardit ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë së informacionit (Information Security Management System - ISMS), për krijimin, implementimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi menaxhimi të sigurisë së informacionit, për menaxhimin e informacionit dhe mbrojtjen nga kërcënimet.

Megjithatë, nga analizimi i përmbajtjes së dokumentacionit rezulton se, në raport me proceset përpunuese që ushtron gjatë aktivitetit sipas standardit ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë së informacionit, Kontrolluesi nuk disponon politika/procedura apo akte rregullatore që janë dokumente shoqëruese të tilla si, “Raporti Final të auditit të standardit”, “Politikat e Menaxhimit të Incidenteve të Sigurisë”, “Regjistrat e gjurmimit të brendshëm dhe gjetjet”, etj.

Gjithashtu, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete, në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të Kreut IV, të Udhëzimit nr. 47.

Për sa më sipër, Kontrolluesi nuk ka plotësuar detyrimet në lidhje ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”* (në vijim, *“Udhëzimit nr. 48”*) si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm me organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 26.11.2024, paraqiti pretendimet mbi konstatimet e procesverbalit:

- Lidhur me kategorinë e të dhënave “klientë, furnizues, vizitorë”, Kontrolluesi pretendon se nuk përpunon të dhëna personale, por vetëm të dhëna për qëllim të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Referuar pretendimit të mësipërm, Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave “klientë, furnizues, vizitorë”, i është referuar Formularit të Njoftimit, të deklaruar nga Kontrolluesi. Gjithashtu, për kategorinë vizitorë, të dhënat e tyre përpunohen nëpërmjet CCTV që është instaluar në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të Kontrolluesit.

- Lidhur me afatet kohore të dokumentacionit të grumbulluar, Kontrolluesi pretendon se *“Përpunuesit e Communication Progress shpk, janë përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale të bazuara në mbajtjen në atë formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tej”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, Kontrolluesi duhet të parashikojë afate konkrete për mbajtjen e të dhënave personale, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

- Lidhur me vendosjen e tabelës për sistemin e video survejimit CCTV, Kontrolluesi pretendon se disponon një tabelë dhe ka vendosur në dispozicion provat lidhur me të.

Zyra e Komisionerit konstaton se tabela e vendosur nga Kontrolluesi nuk është formati i miratuar sipas Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejmimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit, të miratuar nga Komisioneri.

- Lidhur me Kontratën me palë të treta, Kontrolluesi pretendon se nuk përpunojnë të dhëna, por suportojnë klientin duke orientuar mbi hapat që duhen për të realizuar procesin.

Sikurse gjendet e analizuar edhe në paragrafin nr. 4 të konstatimeve të pasqyruara në këtë vendim, nga shqyrtimi i kontratës rezulton se, në pikën 3.4 *“Korrigjim i të dhënave”* të Aneksit 1, është parashikuar se klienti mund të kërkojë suport nga ofruesi i shërbimit (Kontrolluesi), lidhur me fshirjen e të dhënave, korrigjim i të dhënave, si dhe monitorimi i veprimeve të përdoruesve mbi një grup të dhënash me kërkesë të klientit.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në kontratë duhet të reflektohen detyrimet sipas parashikimeve në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit.

- Lidhur me Formularin e Njoftimit, Kontrolluesi deklaron se *“...nuk ka fusha të mjaftueshme për të plotësuar.... vizitorët nuk janë objekt i përpunimit të të dhënave... përhapja e të dhënave drejt bankës, si një detyrim ligjor, është i nënkuptueshëm...”*.

Sa i përket këtij pretendimi, Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për *“Njoftim”* mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimet e

vazhdueshme të gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore.

Gjithashtu, në çdo rubrikë të Formularit ka “...specifiko tjetër”, ku mund të plotësohet çdo informacion shtesë sipas gjykimit të Kontrolluesit. Sa i përket përpunimit të të dhënave të vizitorëve, ai kryhet nëpërmjet sistemit të CCTV, që në momentin që këta vizitorë futen në ambientet e Kontrolluesit.

- Lidhur me konstatimin se ka mangësi në dokumentacion, Kontrolluesi pretendon se nuk i janë bërë me dije mangësit, si dhe pretendon se konstatimi se “*masat e marra janë jo të plota në raport me veprimtarinë*”, nuk qëndron.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në konstatimet e procesverbalit i është bërë me dije se mungojnë element si, “Analiza e Ndikimit në të Dhënat Personale”, “Analiza e sigurisë së sistemit të arkivimit” për të gjitha llojet e proceseve përpunuese gjatë ushtrimit të aktivitetit, “Raport vlerësimi mbi sigurinë në sistemin e arkivimit” elektronik dhe fizik, “Kontrolli i sigurisë së sistemit të përpunimit të të dhënave”, “Hapat që duhet të ndërmerren në rast incidentesh të shkeljes së sigurisë së të dhënave personale”, etj.

Dokumentacion ky, i cili duhet të jetë pjesë e grupit të politikave të SMSI, që i është kërkuar Kontrolluesit gjatë hetimit, si dhe me email-in e datës 07.10.2024 “...Keni përcaktuar masa mbrojtëse, sigurie, certifikimi, SMSI, akte rregullatorë, Shoqëri certifikuese, ka ndonjë procedurë për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave personale që përpunohen nga sistemet elektronike”.

Nga mungesa e dokumenteve të mësipërme, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka plotësuar detyrimet në lidhje ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

- Lidhur me pretendimin për certifikimin ISO 27001, Kontrolluesi kërkon kohë për të vendosur në dispozicion raportet audituese, nëse janë të nevojshme.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, me email-in e datës 07.10.2024 drejtuar Kontrolluesit, është kërkuar “A janë kryer audite të dy viteve të fundit për sistemet elektronike që administrohen dhe mirëmbahen nga ana juaj? Nëse po, të vendosen në dispozicion kopje të raporteve të auditit”. Ky dokument duhet të ishte vendosur në dispozicion për t’u administruar në dosjen e hetimit administrativ dhe më pas të shqyrtohej.

- Lidhur me trajnimet e stafit, Kontrolluesi pretendon se Komisioneri nuk ka marrë masa për t’i trajnuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është përgjegjësi e Kontrolluesit të marrë masa të trajnojë punonjësit bazuar në proceset përpunuese që kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre. Komisioneri kryen aktivitete ndërgjegjësuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe jo trajnime specifike bazuar në veprimtarinë e Kontrolluesit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 18, 21, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për të përcaktuar afatet kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjithë proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, të marrë masa për vendosjen e tabelës për sistemin e video-survejjimit CCTV, sipas modelit të miratuar;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
4. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të marrë masa për përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete tekniko-organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
6. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe lidhur me trajnimin e stafit;

7. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;
8. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1, 2 dhe 4 më sipër;
 - (ii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 3 dhe 5 më sipër;
 - (iii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 6 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
10. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 27.12.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi